

DEKLARATË UNIVERSALE



PËR DEMOKRACI

DEKLARATË E MIRATUAR PA VOTIM* NGA ANA E KËSHILLIT NDËRPARLAMENTAR NË SEANCËN E TIJ TË 161-të
(Kajro, 16 shtator 1997)

Këshilli ndërparlamentar,

Duke e konfirmuar, edhe një herë, përkushtimin e Unionit ndërparlamentar të paqes dhe të zhvillimit dhe bindjen se përforsimi i procesit demokratik dhe i institucioneve përfaqësuese në masë të madhe do të kontribuojë në arritjen e këtij qëllimi.

Duke e konfirmuar edhe një herë interesimin dhe përkushtimin e Unionit ndërparlamentar për avancimin e demokracisë dhe vendosjen e sistemit pluralist të sundimit përfaqësues në botë dhe me qëllim që të përforsohen aktivitetet e vazhdueshme dhe të shumëllojshme të saj në këtë sferë,

Duke përkujtuar që çdo shtet ka të drejtë sovranë në mënyrë të lirë të zgjedhë dhe të zhvillojë, në pajtim me vullnetin e qytetarëve, sisteme të veta politike, sociale dhe kulturore pa përzierjen e shteteve të tjera në përputhje të drejtpërdrejtë me Konventën e Kombeve të Bashkuara,

Duke përkujtuar, gjithashtu, Deklaratën universale për të drejtat e njeriut të miratuar më 10 dhjetor 1948, si dhe Marrëveshjen ndërkombëtare për të drejtat njerëzore dhe politike dhe Marrëveshjen ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të miratuar më 16 dhjetor 1966, Konventën ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor të miratuar më 21 dhjetor 1965, dhe Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave të miratuar më 18 dhjetor 1979,

Duke përkujtuar, më tej Deklaratën e kritereve për zgjedhje të lira dhe korrekte, të miratuar në mars të vitit 1994, në të cilën vërtetohet se në secilin shtet autoriteti i qeverisë mund të dalë vetëm nga vullneti i qytetarëve i shprehur në zgjedhje të hapura, të lira dhe korrekte,

Duke iu referuar Programit për demokratizim të prezantuar më 20 dhjetor 1996 nga ana e sekretarit të përgjithshëm të KB në seancën e 51-të të Kuvendit të Përgjithshëm të KB,

E miraton këtë Deklaratë universale për demokraci dhe u bën me dije qeverive dhe parlamenteve në botë që të udhëhiqen në bazë të përmbajtjes së saj:

PJESA E PARË PARIMET E DEMOKRACISË

1. Demokracia është ideal dhe qëllim i pranuar universal, që bazohet në vlerat e përbashkëta midis njerëzve në tërë bashkësinë botërore pa marrë parasysh dallimet kulturore, politike, sociale dhe ekonomike. Sipas kësaj, ajo është e drejtë themelore e njeriut e zbatuar në kushtet e lirisë, të barazisë, transparencës dhe përgjegjësisë, me respekt të veçantë ndaj pikëpamjeve të shumta dhe në interes të rregullimit shtetëror.

2. Demokracia njëkohësisht është ideal i cili duhet të arrihet dhe model i qeverisjes i cili duhet të zbatohet në pajtim me modalitetet që e shprehin shumëllojshmërinë e përvojave dhe veçorive kulturore pa u nënvlerësuar parimet, normat dhe standardet e pranuar ndërkombëtare. Ndaj, kjo është gjendje e vazhdueshme avancimi dhe përsosje ose kusht përparimi i cili varet nga faktorë të ndryshëm politik, social, ekonomik dhe kulturor.

3. Si ideal, qëllimi kryesor i demokracisë është ruajtja dhe avancimi i dinjitetit dhe të drejtave themelore të individit, për arritjen e së drejtës sociale, nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe social të bashkësisë, përforsimin e kohezionit të shoqërisë dhe përforsimin e paqes nacionale, si dhe krijimin e klimës së dëshiruar për paqe ndërkombëtare. Si formë e sundimit, demokracia është mënyrë më e mirë për arritjen e këtyre qëllimeve, gjithashtu ajo është sistem i vetëm politik që ka kapacitetin e vetëkorrigjimit.

4. Arritja e demokracisë nënkupton partneritet të hapur midis burrave dhe grave në zgjidhjen e problemeve në shoqërinë në të cilën punojnë në barazi dhe komplementarizëm, duke tërhequr plotësim të ndërsjellë nëpërmjet dallimeve të veta.

5. Gjendja demokratike siguron që procesi nëpërmjet të cilit arrihet në pushtet, praktikohet dhe ndryshohet, lejon gara politike dhe është produkt i pjesëmarrjes së hapur, të lirë dhe jodiskriminuese të njerëzve, të zbatuar në pajtim me sundimin e së drejtës, në fjalë dhe frymë.

6. Demokracia është e pandarë nga të drejtat e rregulluara me instrumentet ndërkombëtare për të cilat theksohet në preambulë. Andaj këto të drejta domosdo duhet të zbatohen në mënyrë efikase dhe aplikimi përkatës i tyre doemos duhet të jetë në pajtim me përgjegjësitë individuale dhe kolektive.

7. Demokracia bazohet në parësinë e së drejtës dhe në zbatimin e të drejtave të njeriut. Në shtetin demokratik askush nuk është mbi ligjin dhe të gjithë janë të barabartë para ligjit.

8. Paqja dhe zhvillimi ekonomik, social dhe kulturor, së bashku, janë kushte për demokraci dhe janë fryt i demokracisë. Nga kjo, ekziston varësi e brendshme ndërmjet paqes, zhvillimit, respektimit dhe vëzhgimit të sundimit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut.

PJESA E DYTË ELEMENTET DHE ZBATIMI I SUNDIMIT TË DEMOKRACISË

9. Demokracia bazohet në ekzistimin e institucioneve mirë të strukturuar dhe funksionale, si dhe në standardet dhe rregullat e ndryshme dhe në vullnetin e shoqërisë, të njoftuar plotësisht me të drejtat dhe përgjegjësitë e veta.

INTER-PARLIAMENTARY UNION

Chemin du Pommier 5, PO Box 330, 1218 Le Grand Saconnex · Geneva, Switzerland

Tel: +41 22 919 4150, Fax: +41 22 919 4160 · E-mail: postbox@mail.ipu.org, Internet: <http://www.ipu.org>



DEKLARATË UNIVERSALE PËR DEMOKRACI

10. Institucionet demokratike ndërmjetësojnë në zgjidhjen e tensioneve dhe mbajnë baraspeshë ndërmjet kërkesave të kundërta për llojllojshmëri dhe barazi, individualitet dhe kolektivitet, me qëllim që të përforcohet kohezioni dhe solidariteti social.

11. Demokracia bazohet në të drejtën që secili të përfshihet në zgjidhjen e çështjeve publike; kështu që kërkon ekzistimin e institucioneve përkatëse në të gjitha nivelet, e veçanërisht parlament në të cilin janë të përfaqësuar të gjithë komponentët e shoqërisë dhe i cili i ka autorizimet dhe mjetet e nevojshme, që ta shprehë vullnetin e njerëzve përmes nxjerrjes së legjislationit dhe kryerjen e kontrollit ndaj veprimeve të qeverisë.

12. Element kryesor në zbatimin e demokracisë është mbajtja e zgjedhjeve të lira dhe korrekte në intervalet e rregullta kohore, duke mundësuar që të shprehet vullneti i qytetarëve. Këto zgjedhje doemos duhet të zbatohen në bazë të votimit universal, të barabartë dhe të së drejtës për votim të fshehtë, kështu që votuesit do të mund t'i zgjedhin përfaqësuesit e vet në kushte të barazisë, në mënyrë të hapur dhe transparente, të cilat do ta stimulojnë garën politike. Për këtë qëllim të drejtat e njeriut dhe të drejtat politike janë kyçe, veçanërisht të drejtat për të zgjedhur dhe për të qenë i zgjedhur, e drejta e të shprehurit të lirë në Kuvend, qasja të informatat dhe e drejta e organizimit në parti politike dhe e kryerjes së aktiviteteve politike. Organizimi partiak, aktivitetet, financimi dhe etika doemos duhet të jenë të rregulluara në mënyrë përkatëse të pavarur, me qëllim që të sigurohet integriteti i proceseve demokratike.

13. Funkzioni kyç i shtetit është që të sigurojë gëzimin e të drejtave të njeriut, të drejtave politike, ekonomike dhe sociale qytetarëve të vet. Nisur nga kjo, demokracia shkon bashkë me qeverinë efikase, të ndershme dhe transparente, të zgjedhur në mënyrë të lirë dhe përgjegjëse për udhëheqjen e saj me çështjet publike.

14. Përgjegjësia para opinionit, që është kyçe për demokracinë, ka të bëjë me të gjithë bartësit e funksioneve publike, qofshin të zgjedhur apo jo, dhe për të gjitha organet me kompetenca publike, pa përjashtim. Përgjegjësia kërkon të drejtën publike për qasje të informatat për aktivitetet e qeverisë, të drejtën e paraqitjes së peticioneve qeverisë dhe kërkesën e ndryshimeve përmes mekanizmave të pavarura administrative dhe gjyqësore.

15. Jetën publike në tërësi doemos duhet ta karakterizojë etika dhe transparenca, si dhe themelimi i normave dhe procedurave përkatëse për përkrahje.

16. Pjesëmarrja individuale në proceset demokratike dhe në jetën publike në të gjitha nivelet, doemos duhet të jenë të rregulluara në mënyrë të pavarur dhe korrekte, dhe doemos duhet të nënkuptojë moskëzimin e çfarëdolloj diskriminimi, si dhe rrezikun e frikësimit nga ana e pjesëmarrësve shtetërorë dhe jashtetërorë.

17. Institucionet gjyqësore dhe mekanizmat e pavarur, të paanshëm dhe efikas për mbikëqyrje, janë themel për sundimin e së drejtës mbi të cilën bazohet demokracia. Me qëllim që këto institucione dhe mekanizma ta sigurojnë tërësisht respektimin e rregullave, ta përmirësojnë rregullsinë e proceseve dhe korrigjimin e padrejtësive, doemos duhet të ekzistojë qasja të të gjitha këshillat juridike dhe administrative në bazë të barazisë dhe respektimit të vendimeve administrative dhe gjyqësore nga ana e organeve shtetërore dhe përfaqësuesve të pushtetit dhe nga ana e çdo anëtarë të shoqërisë.

18. Derisa ekzistimi i shoqërisë aktive qytetare është element kyç i demokracisë, kapaciteti dhe dëshira e individëve të marrin pjesë në procesin demokratik dhe të marrin vendime në aspekt të sundimit nuk mund të merret si çështje e kryer. Prandaj, është e domosdoshme që të zhvillohen kushte të volitshme për zbatimin në mënyrë të hapur të të drejtave të participimit, duke i eliminuar njëkohësisht pengesat që e rëndojnë, pengojnë apo pamundësojnë këtë zbatim. Ndaj, është e domosdoshme që të sigurohet forcimi i përhershëm, mes tjerash, i barazisë, transparencës dhe edukimit dhe të evitohen pengesat si padituria, jotoleranca, apatia, mungesa e zgjedhjes së hapur dhe alternativave; mungesa e masave të krijuara për kompensimin e jobaraspeshës ose diskriminimit të natyrës sociale, kulturore, religjioze dhe racore ose të gjinisë.

19. Demokracia e qëndrueshme kërkon klimë dhe kulturë demokratike, gjithmonë të kultivuar dhe përforcuar me edukim dhe me mjete të tjera në sferën e kulturës dhe të informimit. Rrjedhimisht, shoqëria demokratike doemos duhet t'i përkushtohet edukimit në kuptimin më të gjerë të fjalës, veçanërisht arsimit qytetar dhe formimit të shoqërisë me përgjegjësi.

20. Proceset demokratike nxiten nga mjedisi i volitshëm ekonomik, kështu që, në angazhimin e vet për zhvillim, shoqëria doemos duhet t'i përkushtohet plotësisht të nevojave themelore ekonomike të atyre me të drejta të cenuara, me këtë rast duke u siguruar integritimin e plotë në procesin demokratik.

21. Demokraci nënkupton lirinë e mendimit dhe të shprehjes, kjo nënkupton lirinë e mendimit pa ndikim si dhe kërkesën, marrjen dhe shfaqjen e informacioneve dhe të ideve përmes cilitdo medium pa kufizim.

22. Institucionet dhe proceset e demokracisë doemos duhet të përfshijnë pjesëmarrjen e çdo njeriu në shoqëritë homogjene si dhe heterogjene me qëllim të sigurohet llojllojshmëria, pluralizmi dhe e drejta e llojllojshmërisë në kushte të tolerancës.

23. Institucione dhe proceset demokratike, gjithashtu duhet të nxisin udhëheqje dhe administrim të decentralizuar lokal dhe rajonal, që është e drejtë dhe nevojë, dhe që mundëson zgjerimin e bazës së pjesëmarrjes të opinionit publik.

PJESA E TRETË DIMENSIONI NDËRKOMBËTAR I DEMOKRACISË

24. Demokracia gjithashtu duhet të pranohet edhe si parim demokratik ndërkombëtar, i zbatueshëm në organizatat ndërkombëtare dhe shtetet në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare. Parimi i demokracisë internacionale nuk nënkupton vetëm përfaqësimin e barabartë dhe të drejtë të shteteve, por t'i përfshijë edhe të drejtat ekonomike dhe detyrimet e shteteve.

25. Parimet e demokracisë doemos duhen të zbatohen në ballafaqimin ndërkombëtar me probleme me interes global dhe trashëgimisë të përbashkët të njerëzimit, veçanërisht të ambientit të njeriut.

26. Për ruajtjen e demokracisë ndërkombëtare, shtetet doemos duhen të sigurojnë se sjellja e tyre është në përputhshmëri me të drejtën ndërkombëtare, duke u përmbajtur nga përdorimi i kërcënimit dhe forcës ose të sjelljes e cila e rrezikon ose cenon sovranitetin dhe integritetin politik ose territorial të shteteve të tjera, dhe ndërmarrjen e hapave për tejkalimin e dallimeve me mjete paqësore.

27. Demokracia doemos duhet t'i përkrahë parimet demokratike në marrëdhëniet ndërkombëtare. Në këtë kuptim, demokracitë doemos duhen të përmbahen nga sjellja jodemokratike, të shprehin solidaritetin me qeveritë demokratike dhe pjesëmarrësit jo shtetërorë si organizatat joqeveritare të cilat punojnë në interes të demokracisë dhe të drejtave të njeriut, dhe të shprehin solidaritet me viktimat e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e regjimeve jodemokratike. Me qëllim që të përforcohet e drejta penale ndërkombëtare, demokracitë doemos duhet të jenë kundër mosdënimit të kriminalitetit ndërkombëtar dhe shkeljeve serioze të të drejtave themelore njerëzore, si dhe ta përkrahin formimin e gjykatës së përhershme për drejtësi.

• • • • •
* Pas miratimit të Deklaratës, delegacioni i Kinës shprehu rezerva ndaj tekstit.

INTER-PARLIAMENTARY UNION

Chemin du Pommier 5, PO Box 330, 1218 Le Grand Saconnex · Geneva, Switzerland

Tel: +41 22 919 4150, Fax: +41 22 919 4160 · E-mail: postbox@mail.ipu.org, Internet: <http://www.ipu.org>

